



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/2118

Datë: 09.11.2020

Procesverbal

i mbledhjes se VIII (tetë) të rregullt për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa
REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor Financiar për vitin 2020.
3. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi rreth mbjelljeve vjeshtore.
4. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së, për përgatitjet dimërore nëpër shkolla.
5. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, për të hyrat vetanake Janar-shtator 2020.
6. Shqyrtimi i kërkesave.
7. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 16.10.2020 duke filluar në ora 13:50, morën pjesë 7 anëtarë të KPF-së, zyra për informim, drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithë lidhur me materialin e mbledhjes ska mund tju vijë më herët pasi që drejtoritë nuk e kanë sjellë me kohë materialet. Një kërkesë e kemi nga Kryetari i Komunës lidhur me shkollën e fshatit Panorç, edhe pse kjo kërkesë ka qenë disa herë.

Alban Krasniqi: Lidhur me materialin e kësaj mbledhje jam në gjendje qofte një ditë tjetër me mbajtur mbledhjes, por edhe sot veç sa mundemi me kanë efikas pasi qe s'kemi material.

Valon Krasniqi: Edhe unë pajtoj të shtyhet mbledhja, por nëse veç shumica vendos me mbajt sot e mbajmë.

Raimonda Krasniqi: Edhe pse e kemi të vështirë për shkak te vonesës së ekzekutivit unë jam që sot të mbahet mbledhja.

Filloreta Bytyçi: Edhe unë jam ta mbajmë mbledhjen mbasi ska pika shumë.

Muharrem Morina: E keni edhe një kërkesë lidhur me pikën e transferit të mbeturinave.

Alban Krasniqi: Duhet me marrë sqarim nga Ministria për kriteret pastaj me caktuar lokacionin e jo me vendosë kështu.

Hashim Vrenezi: Për pikat që ska material tjetër herë mos i futni në rend të ditës, s'është korrekte me ardhur në mbledhje e me shty pika e rendit te ditës në mungesë të materialeve.

Rahim Morina: Kush jeni që të futet në rend të ditës kërkesa nr.01/1055 datë:14.10.2020 për marrjen e vendimit, për ndërrimin e pronës publike me pronë private, për interes publik me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Panorç, KK.Malishevë.

Për ish-in 1, kundër 1, abstenime 4

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Rahim Morina: Kush jeni për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Për ish-in 5, kundër s'kishte, abstenime 1.

2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor Financiar për vitin 2020.

Rrahim Morina: Unë jam më rekomanduar për Kuvend, kush jeni qe ta rekomandojmë? Për ish-in 5, kundër 1, abstenime s'kishte.

3. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi rreth mbjelljeve vjeshtore.

Alban Krasniqi: Raportet po vijnë të varfra, informacionet e paraqitura në këtë Raport nga Drejtoria për Bujqësi nga sigurohen, nga vijnë këto të dhëna dhe sa janë relevante.

Të sillen të dhëna në nivel të fshatrave: sa hektar toke janë për mbjellje, kultura e tyre pra të dhënat përfundimtare.

Hashim Vrenezi: A ka pas shpërndarje të drejtë të subvencioneve, të sillet lista e aplikuesve dhe e përfituesve të subvencioneve.

Filloreta Bytyçi: Të kemi raporte me të detajuara.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë për kuvend? Për ish-in 5, kundër 1, abstenime s'kishte.

4. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së, për përgatitjet dimërore nëpër shkolla.

Alban Krasniqi: Një raport të veçantë te kemi, Raport të veçantë të shpenzimit për ngrohje në shkolla dhe shfrytëzimit të lëndëve djegëse, si do të behët shpërndarja e lëndëve djegëse, sa është planifikimi dhe lloji i lëndës djegëse që do të shpërndahet nëpër shkolla. Cilat janë planet në rast të përhapjes së COVIC-19, dhe cilat janë planet në rast të organizmit të mësimin online dhe a ka ndonjë plan për paisje me teknologji informative.

Informacion sa konkurse janë shpallur nga DKAE, lista e mësimdhënësve që kanë aplikuar dhe atyre që janë pranuar.

Sa drejtor të shkollave janë ende ushtrues detyre nëpër Shkolla.

Raimonda Krasniqi: Sa është numri i shkollave që kanë nevojë për renovim dhe cilat shkolla, a parashihet renovimi i shkollës "Hasan Prishtina" në fshatin Tërpezë. A është në njohuri DKAE që në shkollën "Imer Krasniqi" në fshatin Carrallukë hyn uji brenda objektit të Shkollës.

Alban Krasniqi: Në cilat Shkolla ka paraparë DKAE renovimin e kaldajave dhe kur është bërë riparimi i fundit i kaldajave nëpër objekte shkollore.

Rrahim Morina: Gjitha këto që po kërkon do te ju drejtojmë këto kërkesa Drejtorive me shkrim, kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Për ish-in 5, kundër 1, abstenime s'kishte.

Lidhur me pikën e radhës drejtori i Financave na ka thënë se kjo pjesë e të hyrave është në raportin nëntëmujor që e rekomandam për kuvend.

5. Shqyrtimi i kërkesave.

kërkesa nr. 02/382 datë: 09.10.2020 e parashtruar nga Hatixhe Berisha nga fshati Kërvaseri.

Filloreta Bytyçi: Kjo vuan që dy vite nga kanceri sepse e njoh, por edhe gjendjen e kanë të vështirë.

Alban Krasniqi: Për këto të dhëna ka një rregull qe duhet të ceken në kërkesën kur e parashtron , pastaj i mungon xhirollogaria.

Filloreta Bytyçi: Unë as qe kam ditë që ka bërë kërkesë, edhe si fshat ndonjëherë i kemi ndihmuar.

Rrahim Morina: Kush jeni që ta ndihmojmë me 900 euro? Unanimisht ish-in për.

Kërkesa nr.02/381 datë: 08.10.2020 e parashtruar nga banoret e 4 familjeve Gegaj,Lagja Munishaj-Fshati i Ri.

Valon Krasniqi: Këtë kërkesë e kanë bërë me plot të drejtë, sepse kjo ka qenë e paraparë edhe në vitin 2019.

Alban Krasniqi: Ky është një fshat malor e kjo rrugë është ndoshta jetikë për ata banorë. Të shkon si pikë në kuvend të trajtohet dhe te kemi informacione nga Urbanizmi dhe Emergjencia, sepse bëhet fjalë për mbijetesë.

Rrahim Morina: Kush jeni pra kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Për ish-in 2, kundër s'kishte. Abstenime 4.

6. Të ndryshme.

Alban Krasniqi: Lidhur me Qëndren e banimit social Urbanizmi te sjellë raport teknik, Drejtoria për Shërbime Publike te sqaroj çka ka ndodhur në atë proces.

Rrahim Morina: Unë këto i kam kërkuar disa herë.

Milazim Morina: Arsyeja pse s'është lëshuar qendra e banimit social është problem i rrymës asgjë tjetër, lidhur me kërkesën për caktimin e lokacionit për transfer të mbeturinave nga ju po kërkoj pse nuk po e caktoni në lokacion për transfer të mbeturinave.


Alban Krasniqi: Shkoni merrni praktikat në Komuna tjera pastaj ejani këtu dhe ne kemi me ju ba zgjidhje.

Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00

Procesmbajtësi

Naim Avdiqaj jur. i dip



Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina

